



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381-38-244183  
Fax: +381-38-244187

URL: <http://www.uni-pr.edu>  
Mail: [rektorati@uni-pr.edu](mailto:rektorati@uni-pr.edu)

## Universiteti i Prishtinës shpall

### KONKURS

#### PËR REGJISTRIMIN E STUDENTËVE NË VITIN E PARË TË STUDIMEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011

Universiteti i Prishtinës, në vitin e parë të studimeve, në afatin e parë të konkursit për vitin akademik **2010-2011**, do të regjistrojë **17362** studentë, prej të cilëve **16332** studentë të rregullt dhe **1030** studentë me korrespondencë.

Universiteti do të regjistrojë edhe **413** studentë të rregullt nga Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Presheva, Medvegja e, Bujanoci, si dhe **216** studentë nga minoritetet: turq, boshnjakë, romë, ashkalinj dhe egjiptianë.

Të drejtë pranimi në Universitetin e Prishtinës kanë të gjithë kandidatët të cilët e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Kosovë dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer.

Në Universitet mund të pranohen edhe studentët nga shtetet e tjera, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHT-i.

Kandidatët jokosovarë dhe minoritarë kanë të drejtë të konkurrojnë dhe të pranohen vetëm në kuotat e parapara për ta.

**Kandidatë jokosovarë konsiderohen ata kandidatë që e kanë mbaruar shkollimin e mesëm jashtë Kosovës dhe me rastin e paraqitjes në konkurs, duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet e shkollimit.**

Njohja (nostrifikimi) e diplomave bëhet në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Kandidatët që refuzohen mund t'i paraqesin ankesë Këshillit të Fakultetit, të njëjtën ditë kur janë njoftuar për rezultatet e provimit pranues. Pas këtij afati, ankesat nuk do të pranohen. Këshilli merr vendim për ankesën ditën e nesërme.

#### MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

Përzgjedhja e kandidatëve behët sipas këtyre kriterëve:

**1. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës, si dhe për kandidatët që paraqiten për pranim në Universitetin e Prishtinës e të cilët nuk e kanë kryer shkollën e mesme në Republikën e Kosovës:**

Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100:

- Deri 20% të pikëve mund të arrihen nga sukcesi në shkollën e mesme dhe
- Deri 80% të pikëve mund të arrihen në provimin pranues në fakultet.

**2. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:**

Numri maksimal i pikëve sipas suksesit dhe provimit pranues është 100:

- Deri në 20% të pikëve mund të arrihen nga sukcesi në shkollën e mesme ,
- Deri në 50% të pikëve mund të arrihen nga provimi i maturës dhe
- Deri në 30% të pikëve mund të arrihen në provimin pranues në fakultet

Secila dëftesë e shkollës së mesme të lartë vlerësohet mbi bazën e suksesit maksimalisht me pesë pikë.

Kandidatët që janë: anëtarë të familjeve të dëshmorëve, invalidë të luftës, fëmijë të invalidëve të luftës, veteranë të luftës dhe fëmijë bonjakë të viktimave civile të luftës do të kenë 10 pikë bonus.

Për kandidatët nga pika 1. në Provimin pranues, prej 80% të pikëve, 40% të pikëve mund të arrihen nga pjesa teorike dhe 40% nga pjesa praktike.

Për kandidatët nga pika 2. në Provimin pranues, prej 30% të pikëve, 15% të pikëve mund të arrihen nga pjesa teorike dhe 15% nga pjesa praktike.

Të drejtë radhitje përkatësish pranimi, sipas pikave 1. dhe 2. kanë vetëm kandidatët që arrijnë **30%** nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.

Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues më së shumti në tri lëndë mësimore, të cilat i caktojnë vetë fakultetet.

Fakultetet me specifika të veçanta organizojnë provim praktik në lëndë dhe disiplina përkatëse.

Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve është i barabartë, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të përgjithshëm nga shkolla e mesme. Nëse edhe pas kësaj do të kemi të njëjtën dukuri, merret sukcesi nga lëndët e ngushta profesionale. Nëse dukuria e numrit të barabartë të pikëve përsëritet, zgjedhjen e kandidatëve (deri te numri i paraparë për regjistrim) do ta bëjë komisioni përkatës i fakultetit.

Fakultetet janë të obliguara që tërë ranglistën e kandidatëve të cilët kanë konkurruar t'ia dërgojnë Rektoratit të Universitetit.

Për funksionimin e departamentit, seksionit, degës apo drejtimin të fakultetit është i nevojshëm numri minimal prej 20 studentëve, përveç Fakultetit të Arteve, ku grupi mund të formohet edhe me më pak studentë.

Regjistrimi i studentëve të pranuar në vitin e parë bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit, sipas orarit të përcaktuar me këtë konkurs.

## **AFATET E KONKURSIT**

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve datat e sendërtimit të konkursit janë si vijon:

**Paraqitja e dokumenteve zgjat prej datës 16.7.2010 deri më 26. 7. 2010.**

***Provimi pranues do të mbahet më 30. 7. 2010, në orën 9:00, përveç në disa fakultete ku orari i mbajtjes së provimit pranues është si vijon:***

- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në orën 11:00
- Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në orën 13:00
- ***Provimi pranues për Fakultetin e Mjekësisë dhe Fakultetin Ekonomik do të mbahet më 31.7.2010, në orën 9:00.***

**Shpallja e rezultateve të provimit pranues do të bëhet më 5.8.2010.**

**Regjistrimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet sipas fakulteteve dhe këtij orari:**

- Fakulteti Filozofik më **9. 8. 2010** prej orës **9:00 - 15:00** në Fakultetin Filozofik,
- Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore më **9. 8. 2010** prej orës 9:00 - 15:00, në Amfiteatrin e Fizikës së FSHMN-së;
- Fakulteti i Filologjisë dhe Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit më **10. 8. 2010** prej orës 9:00 - 15:00, në Amfiteatrin e Fizikës së FSHMN-së;
- Fakulteti i Bujqësisë më **10. 8. 2010** prej orës 9:00 - 15:00 në Fakultetin e Bujqësisë,
- Fakulteti Juridik Qendra në Prishtinë më **11. 8. 2010**, prej orës 9:00 – 15:00 në Amfiteatrin e Fakultetit Juridik,
- Fakulteti Ekonomik Qendra në Prishtinë më **12. 8. 2010**, prej orës 9:00 -15:00 në Amfiteatrin e Fakultetit Ekonomik;
- Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Fakulteti i Mjekësisë më **13 . 8. 2010**, prej orës 9:00 -15:00 në Amfiteatrin 408.

- Fakulteti Juridik Qendra në Gjilan, Fakulteti Ekonomik Qendra në Gjilan dhe Fakulteti i Edukimit Qendra në Gjilan më **16. 8. 2010**, prej orës 10:00 -14:00 në Fakultetin e Edukimit në Gjilan

- Fakulteti i Edukimit Qendra në Gjakovë dhe Fakulteti i Filologjisë Qendra në Gjakovë dhe Fakulteti i Edukimit Qendra në Prizren, më **16 .8. 2010**, prej orës 10:00 -14:00 në Fakultetin e Edukimit në Gjakovë.

- Fakulteti i Edukimit Qendra në Prishtinë dhe Fakulteti i Arteve më **17 .8. 2010**, prej orës 09:00-15:00 në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë.

- Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në Biznes në Pejë dhe Fakulteti Juridik Qendra në Pejë më **18. 8. 2010**, prej orës 10:00-14:00 në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara në Biznes në Pejë.

- Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë, Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara në Mitrovicë dhe Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara në Ferizaj më **19.8.2010** prej orës 10:00-14:00 në Fakultetet përkatëse.

**Regjistrim të kandidatëve jashtë këtyre afateve nuk do të ketë, prandaj luten kandidatët e pranuar që t'i përmbahen afatit të lartcekur.**

Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:

1. Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret me rastin e regjistrimit,
2. Tri fotografi (formati 4.5 x 6 cm), të cilat duhet të jenë sipas normave dhe rregullave për dokumente personale.
3. Pagesa për një semestër në lartësi prej **90 €** për studime të rregullta, respektivisht **250€** për studime me korrespondencë.

**Pagesa bëhet në njërin prej bankave afariste me fletëparaqitje për pagesë, e cila merret në fakultet.**

**Me rastin e paraqitjes për pranim, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente origjinale:**

- Certifikatën e lindjes (nuk është me rëndësi data e lëshimit të saj),
- Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme,
- Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme ose dëftesën e maturës, nëse ka patur provim të maturës,
- Kandidatët që janë: anëtarë të familjeve të dëshmorëve, invalidë të luftës, fëmijë të invalidëve të luftës, veteranë të luftës dhe fëmijë bonjakë të viktimave civile të luftës duhet të paraqesin dëshminë për këtë të lëshuar nga Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve, Shoqata e Veteranëve të Luftës, Shoqata e Invalidëve të luftës dhe organit përkatës komunal.
- Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit,
- Pagesën prej **10** . Forma e pagesës merret në fakultetin përkatës, ndërsa pagesa bëhet në bankë.

**Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet ta kenë me vete vetëm lejen e njoftimit.**

Shtetasit e huaj, që nuk e kanë mbaruar shkollimin e mesëm në gjuhën shqipe, përveç dokumenteve të lartcekura, paraqesin edhe dëshminë mbi njohjen e gjuhës shqipe. Paraqitja e dokumenteve për Fakultetin e Edukimit bëhet nëpër qendra.

Njoftimet dhe programet për provimet pranuese mund të merren në fakultetet përkatëse.

**Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të kenë kopje të mjaftueshme të dokumenteve, sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.**

*Në departamentet, degët dhe drejtimet ku nuk plotësohet numri i kandidatëve të paraparë me këtë konkurs, do të shpallet konkursi plotësues.*

Për informata më të hollësishme kandidatët mund t'u drejtohen fakulteteve përkatëse ose të hapin faqen e internetit: [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

## I. FAKULTETI FILOZOFIK-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **1085** studentë, prej të cilëve **965** të rregullt dhe **120** me korrespondencë:

	Për studime të rregullta	Për studime me korrespondencë
<b>Departamenti i Filozofisë</b>	<b>100</b>	<b>20</b>
<b>Departamenti i Pedagogjisë</b>	<b>200</b>	<b>200</b>
Drejtimi Pedagogji e Përgjithshme	120	20
Drejtimi Pedagogji Sociale	80	-
<b>Departamenti i Historisë</b>	<b>180</b>	<b>20</b>
<b>Departamenti i Shkencave Politike</b>	<b>150</b>	<b>20</b>
<b>Departamenti i Sociologjisë</b>	<b>180</b>	<b>20</b>
<b>Departamenti i Psikologjisë</b>	<b>110</b>	<b>20</b>
<b>Departamenti i Etnologjisë me Antropologji Kulture</b>	<b>45</b>	<b>-</b>

### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të degëve mësimore të fakultetit dhe atë:

- Në Departamentin e Filozofisë nga Filozofia dhe Sociologjia;
- Në Departamentin e Pedagogjisë nga Edukata qytetare, Psikologjia dhe Filozofia;
- Në Departamentin e Historisë nga Historia e botës, Historia e popullit shqiptar dhe Edukatë qytetare
- Në Departamentin e Shkencave Politike nga Sociologjia, Filozofia dhe Edukata qytetare.
- Në Departamentin e Sociologjisë nga Sociologjia dhe Filozofia.
- Në Departamentin e Etnologjisë dhe Antropologjisë Kulture nga Historia, Letërsia dhe Sociologjia.

## II. FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE - PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **1505** studentë të rregullt, dhe atë:

<b>Departamenti i Matematikës</b>	<b>445</b>
Drejtimi Arsimor	150
Drejtimi i Përgjithshëm	150
Drejtimi Shkencat Kompjuterike	195
<b>Departamenti i Fizikës</b>	<b>280</b>
Drejtimi Arsimor	150
Drejtimi Inxhinierik	130
<b>Departamenti i Kimisë</b>	<b>280</b>
Drejtimi Arsimor	150
Drejtimi Inxhinierik	130
<b>Departamenti i Biologjisë</b>	<b>250</b>
Drejtimi Arsimor	150
Drejtimi Ekologji-Mbrojtje e ambientit	100
<b>Departamenti i Gjeografisë</b>	<b>250</b>
Drejtimi Arsimor	150
Drejtimi Aplikativ	100

### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të departamentit përkatës të fakultetit dhe atë:

- Në Departamentin e Matematikës nga Matematika;
- Në Departamentin e Fizikës nga Fizika;

- Në Departamentin e Kimisë nga Kimia dhe Matematika;
- Në Departamentin e Biologjisë nga Biologjia dhe Kimia;
- Në Departamentin e Gjeografisë nga Gjeografia.

### III. FAKULTETI I FILOLOGJISË-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **1315** studentë, prej të cilëve **1195** të rregullt dhe **120** me korrespondencë:

	Për studime të rregullta	Për studime me korrespondencë
Dega e Gjuhës Shqipe	120	20
Dega e Letërsisë Shqipe	145	20
Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze	250	30
Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane	180	20
Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Frënge	100	10
Dega e Orientalistikës	50	10
Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Turke	50	10
Dega e Gazetarisë	100	-
<b>Qendra në Gjakovë</b>	<b>200</b>	-
Dega e Gjuhës Shqipe	100	-
Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze	100	-

### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të degës përkatëse të fakultetit dhe atë:

- Në Degën e Gjuhës Shqipe nga Gjuha shqipe (me shkrim);
- Në Degën e Letërsisë Shqipe nga Letërsia shqipe (me shkrim);
- Në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze nga Gjuha angleze (me shkrim);
- Në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane nga Gjuha gjermane (me shkrim);
- Në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Frënge nga Gjuha frënge (me gojë);
- Në Degën e Orientalistikës nga Gjuha arabe (me gojë);
- Në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Turke nga Gjuha turke (me gojë);
- Në Degën e Gazetarisë provimi pranues mbahet në formë testi nga lëmenjtë: Gjuhë shqipe, Letërsi shqipe, Qytetërim shqiptar, Qytetërim botëror dhe Ese.

### IV. FAKULTETI JURIDIK-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **3000** studentë, prej të cilëve **2600** të rregullt dhe **400** me korrespondencë dhe atë:

	Për studime të rregullta	Për studime me korrespondencë
<b>Qendra në Prishtinë</b>	<b>1300</b>	<b>200</b>
<b>Qendra në Gjilan</b>	<b>650</b>	<b>100</b>
<b>Qendra në Pejë</b>	<b>650</b>	<b>100</b>

### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët: Fillet e së drejtës, E drejta kushtetuese dhe Gjuhë shqipe.

### V. FAKULTETI EKONOMIK-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **2290** studentë, prej të cilëve **2000** të rregullt dhe **290** me korrespondencë:

	Për studime të rregullta	Për studime me korrespondencë
<b>Qendra në Prishtinë</b>	<b>1400</b>	<b>140</b>
Departamenti Financa, Banka dhe Kontabilitet	450	50
Departamenti Menaxhment dhe Informatikë	450	50

Departamenti Marketing	200	20
Departamenti Ekonomiks	200	20
Departamenti i Kontabilitetit	100	-
<b>Qendra në Gjilan</b>	<b>600</b>	<b>150</b>
Departamenti Financa, Banka dhe Kontabilitet	300	75
Departamenti Menaxhment dhe Informatikë	300	75

#### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët: Hyrje në ekonomi, Matematikë.

#### VI. FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **480** studentë të rregullt dhe atë:

<b>Departamenti i Ndërtimtarisë</b>	<b>370</b>
Drejtimi Konstruktiv	180
Drejtimi Hidroteknik	110
Drejtimi Gjeodezi	80
<b>Departamenti i Arkitekturës</b>	<b>110</b>

#### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga Matematika, ndërsa në Departamentin e Arkitekturës edhe nga Perceptimi i hapësirës dhe Vizatimi i lirë(sllajdi).

#### VII. FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **1000** studentë të rregullt dhe atë:

Departamenti i Kompjuterikes	200
Departamenti i Telekomunikacionit	200
Departamenti i Elektronikës	150
Departamenti i Automatikës	150
Departamenti i Sistemeve Elektroenergjetike	150
Departamenti i Elektroenergjetikes Industriale	150

#### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lënda Matematikë

#### VIII. FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **800** studentë të rregullt dhe atë:

Departamenti i Prodhimtarisë dhe Automatizimit	200
Departamenti i Termoteknikës dhe Termoenergjetikës	200
Departamenti i Konstruktimit dhe Disajnit	200
Departamenti i Komunikacionit	200

#### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lënda Matematikë

#### IX. FAKULTETI I MJEKËSISË-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **490** studentë të rregullt dhe atë:

Dega e Mjekësisë së Përgjithshme	150
Dega e Stomatologjisë	50
Dega e Farmacisë	100
Dega e Fizioterapisë	70
Dega e Infermierisë	60
Dega e Mamisë	60

## PROVIMI PRANUES

- Provimi pranues për Degën e Mjekësisë së përgjithshme dhe për Degën e Stomatologjisë mbahet nga lëndët: Kimi dhe Biologji.

- Provimi pranues për Degën e Farmacisë dhe Degën e Fizioterapisë mbahet nga lëndët: Kimi, Biologji dhe Fizikë, ndërsa për Degët Infermieri dhe Mami provimi mbahet nga lëndët: Aritmetikë, Kimi dhe Biologji.

## X. FAKULTETI I ARTEVE-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **222** studentë të rregullt:

<b>Dega e Artit Figurativ</b>	<b>73</b>
Drejtimi i Pikturës	30
Drejtimi i Skulpturës	10
Drejtimi i Grafikës	10
Drejtimi i Dizajnit Grafik	15
Drejtimi i Skenografisë	8
<b>Dega e Artit Muzikor</b>	<b>109</b>
Komponim	4
Dirigjim	4
Solokëndim	7
Piano	7
<i>Drejtimi i Instrumenteve Harkore</i>	<i>19</i>
Violinë	5
Violë	3
Violonçeli	3
Kontrabas	3
Harfa	2
Kitarë	3
<i>Drejtimi i Instrumenteve me të fryrë</i>	<i>28</i>
Flaut	4
Klarinetë	4
Saksafon	1
Trompetë	2
Trombon	3
Tube	3
Fagot	3
Obo	3
Perkusion	3
Korna	2
Pedagogji e Përgjithshme Muzikore	40
<b>Dega e Artit Dramatik</b>	<b>40</b>
Drejtimi Aktrim	15
Drejtimi Dramaturgj	10
Drejtimi Regji filmi	7
Drejtimi Regji teatri	8

## KUSHTET E REGJISTRIMIT

Përveç kushteve të përbashkëta të përcaktuara me konkurs, kandidatët e paraqitur në konkurs për regjistrim në Fakultetin e Arteve duhet t' i plotësojnë edhe këto kushte:

### NË DEGËN E ARTIT FIGURATIV

Për përcaktimin e talentit për krijimtari artistike, kushtet e veçanta për studim në Degën e Artit Figurativ janë:

- Drejtimi i Pikturës: 5 punime të punuara sipas modelit (studimi i kokës dhe figura në përpjesëtime natyrore) dhe së paku 5 punime sipas zgjedhjes së lirë (natyrë e qetë, peizazh, kompozicion etj).

- Drejtimi i Skulpturës: së paku 5 punime nga skulptura sipas modelit, prej të cilave një duhet të jetë studimi i kokës në përpjesëtime natyrore dhe së paku 5 vizatime sipas modelit.

- Drejtimi i Grafikës: së paku 5 punime sipas modelit (studimi i kokës dhe figurës në përpjesëtime natyrore) dhe së paku 5 punime sipas zgjedhjes së lirë (natyrë e qetë, peizazh, kompozicion etj.).

- Drejtimi i Dizajnit Grafik: së paku 5 vizatime sipas modelit (studimi i kokës dhe figurës në përpjesëtime natyrore), si dhe 5 punime nga dizajni grafik (ilustrime, kopertona të librit, ambalazhe etj.).

- Drejtimi i Skenografisë: 10 projekte (skenografi), skica të skenografisë për dramë të caktuar, një skenografi të inskenuar në hapësirë të caktuar.

Kandidatët i shtrohen provimit pranues si vijon:

- Në Drejtimin e Pikturës dhe në Drejtimin e Grafikës: vizatim i kokës sipas modelit të gjallë (2 ditë), vizatim i aktit (2 ditë) dhe pikturim i natyrës së qetë (1 ditë).

Kandidatët punojnë me material të tyre.

- Në Drejtimin e Skulpturës: modeli i kokës sipas modelit të gjallë (3 ditë), vizatim i aktit (2 ditë).

- Në Drejtimin e Dizajnit Grafik: vizatimi i kokës sipas modelit të gjallë (2 ditë), vizatimi i aktit (2 ditë) dhe dizajn grafik (2 ditë). Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohja e përdorimit të kompjuterit.

### **NË DEGËN E ARTIT MUZIKOR**

Kandidatët i shtrohen provimit pranues si vijon:

- Në Drejtimin e Kompozimit: vlerësimi i 3 kompozimeve të dorëzuara, provimi nga lëndët Solfegjo, Harmonia, Polifonia dhe Pianoja.

- Në drejtimet instrumentale provimi nga lëndët kryesore (një koncert, një sonatë dhe një pjesë e lirë për drejtimet e harkorëve dhe frymorëve, kurse për drejtimin e pianos një etidë, pjesa nga Baroku, sonatë dhe pjesë e lirë) si dhe provim nga lëndët: Solfegjo dhe Teoria e muzikës.

- Në Drejtimin Perkusione provimi nga lëndët Solfegjo dhe Teori e muzikës.

### **NË DEGËN E ARTIT DRAMATIK**

Për verifikimin e aftësive të veçanta, kandidatët do të japin këto provime:

#### ***Drejtimi Aktrim:***

Programi eliminues, pjesa e parë përbëhet nga:

- a) Recitim (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- b) Monolog (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- c) Tregim i shkurtër popullor (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- d) Një këngë;
- e) Një imitim;
- f) Një poezi.

Kandidati është i obliguar që t'i mësojë përmendësh dhe t'i përgatisë detyrat. Komisioni, pas programit të shfaqur, mund t'i shtrojë kandidatit edhe detyra plotësuese (improvizime), për të fituar bindje sa më të plotë për aftësitë e kandidatit.

Pjesa e dytë e programit eliminues përbëhet nga: puna me mësimdhënës të caktuar, hartimi i detyrës me shkrim dhe verifikimi përfundimtar i aftësive.

#### ***Drejtimi Regji Teatri dhe Filmi***

Kandidatët sjellin dy platforma regjisoriale me skica për hapësirë skenike.

a) Platforma e parë duhet të jetë e bazuar në tragjedinë e Jul Cezarit të V. Shekspirit, ndërsa platforma e dytë sipas zgjedhjes së lirë të kandidatit.

b) Provimi pranues zhvillohet në dy pjesë:

Pjesa e parë e provimit përbëhet nga vlerësimi i punimeve të sjella dhe vlerësimi i kulturës së përgjithshme të kandidatit, ndërsa pjesa e dytë e provimit pranues (për kandidatët të cilët e kalojnë pjesën e parë të provimit) përbëhet nga inskenimi i një situatë nga Jul Cezari i V. Shekspirit, sipas platformës së tyre regjisoriale.

Kandidatët që konkurrojnë në Regji Filmi duhet t' i shtrohen testit me pyetje të kulturës së përgjithshme, në veçanti nga arti dhe kryesisht nga filmi.

Sinopsis me shkrim në temën e dhënë në pjesën e parë të provimit. Tema jepet menjëherë pas testit në provim.

Kandidatët, që e kalojnë në pjesën e dytë, i mbrojnë para komisionit punimet e veta.

Kandidatët, që e kalojnë në pjesën e tretë, janë të detyruar të gjirojnë vetë në temën e dhënë, film tre minutash.

Literatura e preferuar:

Georg Sodull - "Historia e filmit"

Abaz Hoxha - "Historia e filmit shqiptar"

Luis Herman - Skenari i filmit dhe i televizionit

Jezhi Plazhevski - Gjuha e filmit

Fadil Hysaj: "Teatrollogji, dramaturgji, regji dhe aktrim"

**Drejtimi Dramaturgji:**

1. Hartim me shkrim në temën e lirë,
2. Dialogu me shkrim në temën e tragjedisë,
3. Dialogu me shkrim në temën e komedisë,
4. Testimi me gojë lidhur me njohuritë nga sfera e kulturës së përgjithshme,
5. Testim me gojë nga fusha e dramaturgjisë.

**Literatura për provim pranues:**

1. Aristoteli: "Poetika"
2. Vlladan Shvacov: "Bazat e dramaturgjisë"
3. Dr. Nebi Islami: "Historia e dramës kombëtare 1886-1996"
4. Dr. Josif Papagjoni: "Komedi që vjen nga skena"
5. Eskili: "Orestia"
6. Sofokli: Një tragjedi
7. Aristofani: Një komedi
8. Shekspiri: Një tragjedi
9. Molieri: Një komedi
10. Dramaturgji nga tradita: Anton Santori, Sami Frashëri, Kristo Floqi etj.
11. Dramaturgji bashkëkohore: Anton Pashku, Haqif Mulliqi, Rexhep Qosja, Ymer Shkreli, Flamur Hadri, Ekrem Kryeziu, Nebih Islami, Kasëm Terbeshina etj.

## **XI. FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË-PRISHTINË**

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **950** studentë të rregullt dhe atë:

<b>Drejtimit e Bujqësisë</b>	<b>850</b>
Teknologjia dhe Biotknologjia ushqimore	150
Agroekonomi	150
Blegtori	150
Lavërtari-Perimtari	150
Mbrojtja e bimëve	100
Pemëtari-Vreshtari	150
<b>Drejtimi i Veterinarisë</b>	<b>100</b>

### **PROVIMI PRANUES**

Provimi pranues për Drejtimit e Bujqësisë do të mbahet nga lëndët: Kimi, Biologji dhe Matematikë.

Provimi pranues për Drejtimin e Veterinarisë do të mbahet nga lëndët: Kimi dhe Biologji.

## **XII. FAKULTETI I XEHEHETARISË DHE METALURGJISË-MITROVICË**

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **700** studentë të rregullt dhe atë:

<b>Departamenti i Xehetarisë</b>	<b>150</b>
<b>Departamenti i Gjeologjisë</b>	<b>150</b>
<b>Departamenti i Teknologjisë</b>	<b>280</b>
Drejtimit e tjera	130
Drejtimi Inxhinieria Ushqimore	150
<b>Departamenti për Materiale dhe Metalurgji</b>	<b>120</b>

### **PROVIMI PRANUES**

Provimi pranues mbahet nga lënda: Matematikë

### XIII. FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE DHE SPORTIT-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **200** studentë të rregullt (**120** meshkuj dhe **80** femra)

#### PROVIMI PRANUES

Përmbajtja dhe mënyra e dhënies së provimit pranues është:

1. Gjendja Psiko-Somatike (verifikimi shëndetësor, të folurit, të shikuarit, të dëgjuarit, konstruksioni trupor).
2. Not
3. Aftësitë lëvizore (motorike):
  - Kërcimi nga vendi në gjatësi,
  - Ngritja me forcë në hekur (meshkujt),
  - Përkulje mbi krah (femrat),
  - Shpejtësia në 100 m (matet koha e vrapimit- meshkujt dhe femrat),
  - Qëndrueshmëria në 1000 m(meshkujt) dhe 800 m (femrat) - matet koha e vrapimit,
  - Bashkërendimi (koordinimi lëvizor),
  - Ndjeshmëria ritmike.
4. Njohuritë lëvizore(motorike) sportive:
  - Futboll: puna me top-këmbë dhe kokë
  - Hendboll: pasimet, trehapëshi dhe goditja në portë
  - Basketboll: pasimi me dy duar, driblimi i topit me një dorë, dyhapëshi dhe gjuajtja në kosh.
    - Volejbol: pasimi i topit në çifte me gishta dhe llëra (çekan), gjuajtja dhe pranimi i topit.
5. Gjymnastikë sportive - Lëvizjet me trup të lirë: ekuilibri ballor, vertikalja mbi duar, kapërdimi para, rrotullimi anësor në të dy anët ose ylli (meshkujt dhe femrat).  
Paralele: mbështetje mbi krah, me lëkundje ngritje-para, dalje me trup të shtrirë prapa.

Kandidatët janë të obliguar që në provim të kenë pajisjet sportive.

### XIV. FAKULTETI I EDUKIMIT- PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **1505** studentë të rregullt dhe atë:

<b>Qendra në Prishtinë</b>	<b>1000</b>
Programi fillor	100
Programi parashkollor	100
<i>Programi për shkollën e mesme të ulët</i>	<i>800</i>
Gjuhë dhe letërsi shqipe	100
Matematikë-Informatikë	100
Teknologji-Informatikë	100
Fizikë-Kimi	100
Biologji-Kimi	100
Gjuhë dhe letërsi angleze	100
Histori-Edukatë qytetare	100
Gjeografi-Edukatë qytetare	100
<b>Qendra në Gjilan</b>	<b>200</b>
Programi i arsimit fillor	100
Programi parashkollor	100
<b>Qendra në Prizren</b>	<b>105</b>
Programi i arsimit fillor në Gj. Boshnjake	35
Programi parashkollor në Gj. Boshnjake	35
Programi parashkollor në Gj. Turke	35
<b>Qendra në Gjakovë</b>	<b>200</b>
Programi i arsimit fillor	100
Programi parashkollor	100

### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për Programin fillor dhe Programin parashkollor do të mbahet nga lëndët: Gjuhë shqipe, Matematikë dhe testi i të lexuarit të kuptimshëm.

Provimi pranues për programin për Shkollën e mesme të ulët përbëhet prej:

1. Testi nga lëndët profesionale 64 pikë

2. Testi i të lexuarit të kuptimshëm 16 pikë

Provimi është me shkrim.

### XV. FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA TË BIZNESIT NË PEJË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **1100** studentë, prej të cilëve **1000** të rregullt dhe **100** me korrespondencë:

	Për studime të rregullta	Për studime me korrespondencë
Departamenti Administrim Biznesi	300	30
Departamenti Kontabilitet dhe financa	300	30
Departamenti Menaxhmenti në Turizëm dhe Hotelieri	250	20
Administrimi i Biznesit (gjuhë boshnjake)	150	20

### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për të gjitha departamentet përgatitet nga Manuali i përpiluar enkas për vitin akademik 2010/2011, i cili gjendet në skriptoren e FSHAB-së në Pejë.

### XVI. FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE TË APLIKUARA NË MITROVICË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **400** të rregullt dhe atë:

Departamenti i Informatikës Inxhinierike 200

Departamenti i Makinerisë Industriale 200

### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lënda Matematikë

### XVII. FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE TË APLIKUARA FERIZAJ

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **320** studentë të rregullt dhe atë:

**Departamenti i Makinerisë 160**

Profili - Teknika e përpunimit të materialeve 160

artificiale (Plastmasa)

**Departamenti i Industrisë së Drurit 160**

Profili - përpunimi i drurit 160

### PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lënda Matematikë

Universiteti i Prishtinës do të pranojë edhe **413** studentë nga Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Presheva, Bujanoci, Medvegja dhe atë:

	<b>Fakulteti-Departamenti,Drejtimi</b>	<b>Preshevë, Bujanoc, Medvegjë</b>	<b>Mali I Zi</b>	<b>Shqipëri</b>	<b>Maqedoni</b>
<b>1</b>	<b>Filozofik</b>	<b>14</b>	<b>10</b>	<b>2</b>	<b>7</b>
Departamenti	Filozofi	2	2	1	1
	Pedagogji	2	1	1	1
	Drejtimi Pedagogji e përgjithshme	2	1		1
	Drejtimi Pedagogjia sociale	2	1		1
	Histori	2	1		1
	Shkenca politike	2	1		1
	Sociologji	2	1		
	Psikologji	2	1		1
	Etnologji dhe Antropologji kulturore	2	1		
<b>2</b>	<b>i Shkencave Matematiko-Natyrore</b>	<b>13</b>	<b>9</b>	<b>6</b>	<b>5</b>
	<b>Departamenti i Matematikës</b>	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>1</b>
	<b>Departamenti i Fizikës</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>1</b>
	<b>Departamenti i Kimisë</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>1</b>
	<b>Departamenti i Biologjisë</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>
	<b>Departamenti i Gjeografisë</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>
<b>3</b>	<b>i Filologjisë</b>	<b>19</b>	<b>10</b>	<b>7</b>	<b>7</b>
Dega	Gjuhë shqipe	3	1		
	Letërsi shqipe	2	1		
	Gj.dhe letërsi angleze	2	1	1	1
	Gj. dhe letërsi gjermane	2	1	1	1
	Gj. dhe letërsi frënge	2	1	1	1
	Orientalistikë	1	1		
	Gjuhë dhe letërsi turke	1	1		
	Gazetari	2	1		
	<b>Qendra në Gjakovë</b>	<b>4</b>	<b>2</b>		
Dega	Gj.dhe letërsi angleze	2	1	2	2
	Gjuhë shqipe	2	1	2	2
<b>4</b>	<b>Juridik</b>	<b>15</b>	<b>10</b>	<b>5</b>	<b>5</b>
Qendra ne	Prishtinë	5	3	1	1
	Gjilan	10	2	1	1
	Pejë	5	5	3	3
<b>5</b>	<b>Ekonomik</b>	<b>15</b>	<b>10</b>	<b>5</b>	<b>5</b>
	<b>Qendra ne Prishtinë</b>	<b>5</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>2</b>
	<b>Qendra ne Gjilan</b>	<b>10</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>3</b>
Departament	Financa, banka dhe kontabilitet	5			

i	Menaxhment dhe informatikë	5			
<b>6</b>	<b>i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës</b>	<b>5</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>2</b>
Departamenti	<b>Departamenti i Ndërtimtarisë</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>1</b>
	Konstruktiv	1			
	Hidroteknik	1			
	i Gjeodezisë	1			
	<b>Departamenti i Arkitekturës</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>
<b>7</b>	<b>i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike</b>	<b>6</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>3</b>
Departamenti	i Kompjuterikes	1	1	1	1
	i Telekomunikacioni	1	1	1	1
	i Elektronikës	1	1	1	1
	i Automatikës	1			
	i Sistemeve Elektroenergjetike	1			
	i Elektroenergjetikës Industriale	1			
<b>8</b>	<b>i Inxhiniersë Mekanike</b>	<b>4</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>2</b>
Departamenti	i Prodhimtarisë dhe Automatizimit	1			
	i Termoteknikës dhe Termoenergjetikës	1			
	i Konstruktimit dhe Disajnimimit	1			
	i Komunikacioni	1			
<b>9</b>	<b>i Mjekësisë</b>	<b>8</b>	<b>5</b>	<b>5</b>	<b>5</b>
Dega	Mjekësia e Përgjithshme	2	2	2	2
	Stomatologjia	2	1	1	1
	Farmaci	1	1	1	1
	Fizioterapia	1	1		
	Infermiera	1			
	Mami	1		1	1
<b>10</b>	<b>i Arteve</b>	<b>5</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>3</b>
	<b>Dega Arti Figurativ</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>
	<b>Dega Arti Muzikor</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>
	<b>Dega Arti Dramatik</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>
<b>11</b>	<b>i Bujqësisë</b>	<b>10</b>	<b>5</b>	<b>5</b>	<b>5</b>
	<b>Drejtimet e Bujqësisë</b>	<b>7</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>3</b>
	<b>Drejtimi i Veterinarisë</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>2</b>
<b>12</b>	<b>i Xehetarisë dhe Metalurgjisë</b>	<b>5</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>2</b>
Departamenti	Xehetari	1			
	Gjeologji	1			
	<b>Teknologji</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>1</b>
	Drejtimet tjera	1			
	Drejtimi Inxhinieria Ushqimore per Materiale dhe Metalurgji	1			
			1		
<b>13</b>	<b>i Kulturës Fizike dhe Sportit</b>	<b>5</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>3</b>

	Meshkuj	3			
	Femra	2			
<b>14</b>	<b>i Edukimit</b>	<b>32</b>	<b>12</b>	<b>10</b>	<b>10</b>
	<b>Qendra në Prishtinë</b>	<b>12</b>	<b>6</b>	3	2
	Programi fillor	1			
	Programi Parashkollor	1			
	<i>Programi për shkollën e mesëm të ulët</i>	1			
Drejtimi	Gjuhë dhe letërsi shqipe	2			
	Matematikë-informatikë	1			
	Teknologji-informatikë	1			
	Fizikë-Kimi	1			
	Biologji-Kimi	1			
	Gjuhë dhe letërsi angleze	1			
	Histori-edukatë qytetare	1			
	Gjeografi-edukatë qytetare	1			
	<b>Qendra në Gjilan</b>	<b>15</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>7</b>
	Programi i arsimit fillor	8			
	Programi parashkollor	7			
	<b>Qendra në Gjakovë</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>1</b>
	Programi i arsimit fillor	3			
	Programi parashkollor	2			
<b>16</b>	<b>Fakulteti i Shkenca. te Apliku.të Biznesit-Pejë</b>	<b>5</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>3</b>
Departamenti	Administrim Biznesi	2			
	Kontabilitet dhe financa	1			
	Menaxhment në Turizëm dhe Hotelieri	2			
	Administrimi i Biznesit(Boshnjakisht)				
<b>17</b>	<b>Fakulteti i Shken.Tekni. të Aplikua.Mitrovicë</b>	<b>5</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>3</b>
Departamenti	Informatikë Inxhinierike	3	1		
	i Makinerisë Industriale	2	2		
<b>21</b>	<b>Fakulteti i Shken.Tekni. të Aplikua.Ferizaj</b>	<b>10</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>2</b>
	Departamenti i Makinerisë	5			
Profili	Përpunimi i drurit	5			
	<b>Gjithsej</b>	<b>176</b>	<b>97</b>	<b>68</b>	<b>72</b>

Universiteti i Prishtinës, për mësim në gjuhën shqipe, do të pranojë edhe **216** studentë nga pjesëtarët e komuniteteve: turq, boshnjakë, romë, ashkalinj dhe egjiptianë dhe atë:

	<b>Fakulteti-Departamenti,Drejtimi</b>	<b>Boshnjak</b>	<b>Romë, Ashkali, Egjiptian</b>	<b>Turq</b>
1	Filozofik	6	5	5
2	i Shkencave Matematiko-Natyrore	3	4	3
3	i Filologjisë	4	4	4
4	Juridik	8	7	6
5	Ekonomik	9	7	11
6	i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	4	3	3
7	i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	7	4	4
8	i Inxhinierisë Mekanike	1	1	1
9	i Mjekësisë	15	8	16
10	i Arteve	3	3	2
11	i Bujqësisë	4	3	2
12	i Xehetarisë dhe Metalurgjisë	3	3	2
13	i Kultures Fizike dhe Sportit	4	3	1
14	i Edukimit	6	7	2
16	Fakulteti i Shkenca. te Apliku.të Biznesit-Pejë	1	7	1
17	Fakulteti i Shken.Tekni. të Aplikua.Mitrovicë	1	1	1
21	Fakulteti i Shken.Tekni. të Aplikua.Ferizaj	1	1	1
	Gjithsejt	80	71	65